

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Intervista në Syri Tv -
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917640/mentaliteti-i-rames-abilekaj-perplasja-per-pagat-lu-fte-mes-qeverise-dhe-pushtetit-gjyqesor/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:28:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:03:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e4fbe99c0b2e737a10167348f3978779caeb7bcfd6450015853753f33f5c7e68
TEKSTI	e7ec78102468aadd92f9993a9e16e059d9684a31df0629a873afeb5ebc28fd6c
PAMJA	cec87ee0f28fe0ef760550a6701ffa5f28d78631dfb213c614d477cee0aad0e2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bb82ee937edb24bae97323b9606de6dc9b334ed5cd9abef5a6f2f427c7d058d1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bb82ee937edb24bae97323b9606de6dc9b334ed5cd9abef5a6f2f427c7d058d1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



'Mentaliteti i Ramës', Abilekaj: Përplasja për pagat, luftë mes qeverisë dhe pushtetit gjyqësor

17:03, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



I ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, gazetari Enton Abilekaj u ndal te debati për pagat e gjyqtarëve dhe magistratëve, duke e cilësuar atë si një përplasje mes pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor.

Abilekaj tha se Gjykata Kushtetuese, KLGJ dhe KLP kanë kërkuar që indeksimi dhe rregullimi i pagave të bëhet automatikisht, pa ndërhyrjen e qeverisë.

Gazetari u shpreh se ky mekanizëm do të garantonte pavarësi ekonomike dhe financiare për pushtetin gjyqësor, ndërsa qeveria, përmes ligjit të miratuar, synon të mbajë në dorë mënyrën e përcaktimit të pagave.

"Besoj kjo është një luftë pushtetesh, jo luftë pagash", u shpreh Abilekaj, duke argumentuar se thelbi i debatit nuk është nëse paga e gjyqtarëve rritet apo ulet me disa mijëra lekë, por kush e përcakton atë.

Gazetari deklaroi se ligji i jep ekzekutivit mundësinë të ndikojë në sistemin e pagave të gjyqtarëve dhe magistratëve dhe shtoi se, nëse ligji dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, ai pret që të rrëzohet.

Ai tha se çështja përbën një ndërhyrje të hapur të qeverisë në pushtetin gjyqësor.

Pjesë nga intervista:

Gjykata Kushtetuese, KLGJ dhe KLP kërkuar që preferuan që kjo të bëhet vetvetiu, pra të mos jetë në dorë të qeverisë indeksimi apo rregullimi i pagës së magistratëve, por të bëhet vetvetiu në momentin që qeveria të shikojë pagën. Pra, krijon dhe pushteti gjyqësor një pavarësi ekonomike dhe financiare, që të mos varen nga qeveria. Mos të bëjë llogaritë ministri i Financave se sa duhet ta ketë magistrati, apo sa do ta ulin magistratin, apo t'ia fshehim magistratit, por në momentin që duhet ndryshuar pagat, mos të ketë fare dorë qeveria.

Pikërisht këtë nuk donte qeveria. Për këtë arsye miraton një ligj që ta llogarisë vetë pagën e gjyqtarëve dhe magistratëve sa herë do ajo, mënyrat si do ajo, duke e krijuar një raport i cili është i pashembullt në asnjë vend të botës.

Besoj, kjo është një luftë pushtetesh, jo luftë pagash, sepse është një pushtet nivelsor që kërkon në pagat e tura të mos kontrollohen nga qeveria dhe është

më të lexuarat



'Akuza të stisura politikisht', Saiti: Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës



Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç



Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës



A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...



By Pass i Elbasanit/ 'Karakaci në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen



'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'



qeveria që kërkon që pagat e gjyqtarëve e magistratëve të kontrollohen prej saj gjithmonë.

Prandaj, kjo është një luftë mes pushteteve dhe prandaj vazhdon debati. Nuk është çështja sa e lartë apo e ulët është paga, por kush e përcakton pagën. E ligji apo qeveria, apo ia lëmë Maliqit në dorë që ta bëjë si të dojë indeksimin dhe rritjen e pagës. Qeveria do ta ketë në dorë vetë këtë gjë, këtë mjet.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese prapë do ta rrëzojë këtë ligj, në qoftë se gjyqtarët do ta çojnë në Gjykatë Kushtetuese, pasi është një ligj që i jep të drejtën ekzekutivit të ndrydhë sistemin gjyqësor, jo se llogaritet paga më e ulët apo më e lartë se ato 10 mijë lekë të reja në pagë që mund të ulen. Nuk përbëjnë një problem të madh për ata që i kanë rrogat mbi 3 apo 4 milionë të vjetra, por është një ndërhyrje e qeverisë e hapur në gjyqësor.

Ky është mentaliteti i qeverisjes Rama.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Qytetarët përballen me krizë të çmimeve, Rama premtion transparencë, ndërkohë asnjë masë e marrë



Këlliçi: Për të pasur sukses në Shqipëri, duhet të bëhesh 'si Roni'



Kryeministri Kurti udhëton për në SHBA

Ligji për statusin e magistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

TË NGJASHME



Pagat e magistratëve/ Gjokutaj: Rama zhbëri Gjykatën Kushtetuese, thotë pagat i jap unë, kur dua dhe sa dua



Lajthit Qeveria/ Nisin procedurat e dorëzimit të aeroportit të Vlorës kundër urdhrat të arbitrazhit



Kuvendi miratoi pagat e magistratëve/ Shoqatat e gjyqtarëve e prokurorëve: Do t'i drejtohem GJK!



Von der Leyen anashkalon Serbinë dhe Bosnjën në turneun e saj në Ballkan! Viziton dhe Tiranën



Ftesa për magistratët/ Blushi-Ramës: Pse s'i thirrë para 31 korrikut, kur skadonte afati i GJK?



Pagat e magistratëve, Meta: Rama delirant, nuk njeh Gjykatën Kushtetuese as parimin e shtetit të së drejtës



SYRI TV/ Rama shkon në Kuvend në mesnatë, nuk jep llogari për Ron Yeffet

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.